

Shënim hyrës

Janë shkrimet e para në shtypin e Tiranës nga provinca në gazetën e partisë së parë të shkeputur nga Partëia Demokratike në pushtet.

Vihet re profili i ardhshëm i publicistikës time që lidhet me angazhimi maksimal lidhur me problematikat politike të kohës. Rendësia më ka se një vit më vonë unë zbulova në një gazetë qendrore të vërtetat reale të incidentit të Peshkëpisë së 10.04.1994.

Εισαγωγή

Είναι τα πρώτα άρθρα γνώμης στον κεντρικό τύπο στα Τίρανα από αρθρογράφο από την περιφέρεια. Πρόκειται για την εφημερίδα του πρώτου κόμματος που αποσπάστηκε από το Δημοκρατικό Κόμμα στην κυβέρνηση.

Διαπιστώνεται εύκολα το μελλοντικό δημοσιογραφικό μου προφίλ, δεσμευμένο άμεσα με την πολιτική επικαιρότητα. Ιδιαίτερης σημασίας είναι το άρθρο μέσω του οποίου αποκαλύπτω σε μια κεντρική εφημερίδα την πραγματική αλήθεια σχετικά με το επεισόδιο της Επισκοπής . 10.04.1994.

PËRMBAJTJA

OMONIA e mori një mesazh.

11.02.1995 faq. 3

Hapja e një kapitulli të ri kërkon predispozicion real.

18.02.1995 faq.4

Domosdoshmeria e zgjedhjeve dhe dilema Berishiane

08.04.1995 faq. 5

Marrëdhëniet në udhëkryqin e bisedimeve

09.03.1995 faq. 6

A është thenë gjithcka për Peshkepinë?!

13.04.1995 faq.7

Nga Panajot Barka
OMONIA e mori një mesazh.
 11.02.1995

Nga intervista tek Zeri i Amerikes ditën e lirimit të të 4-ve të OMONOIAS nga burgu

Në këtë shkrim theksohet

Panajot Barka vlerësoi dje vendimin e Gjykatës së kasacionit në favor tëlirimit të katër minoritarëve mbetur në qeli. Duke e konsideruar vendimin si më të mirin që mund të jepej nga një gjykatës shqiptar, Barka deklaroi se tani shpresoj në një klimë tjetër marrëdhëniesh mes dy vendeve . Në intervistën e tij për “Yërin e Amerikës”, Barka vlerësoi qëndrimin e matur të minoritetit grek ndaj këtij problemi, që gjeti menyrën e duhur për të reaguar . Ai tha se shpreson tek një përmirësim të marrëdhënieve mes dy vendeve dhe vlerësoi me këtë rast gadishmerinë e palës greke për fillimin e dialogut. Unë habitem me heshtjen e palës shqiptare, tha Barka. Duke e konsideruar gjyqin e të pesteve një element thelbësor të krizës, Barka

E SHITUNE, 11 SHKURT 1995
 VITI I NR. 10 - CMIMI 10 LEKE

ALEANCA
 E PERDITSHME INFORMATIVE

NACIONALE

Panajot Barka shpreson tek një realizëm politik

Omonia e mori një mesazh



Ish deputeti i Omonias, Panajot Barka, në Prill 1991 duke numëruar votat për zgjedhjen e Ramiz Alisë president i Republikës

Panajot Barka e vlerësoi dje vendimin e Gjykatës së Kasacionit në favor të lirimit të katër minoritarëve të mbetur në qeli. Duke e konsideruar vendimin si më të mirin që mund të jepej nga një gjykatës shqiptar, Barka deklaroi se tani shpreson në një klimë tjetër marrëdhëniesh mes dy vendeve. Në intervistën e tij për “Zërin e Amerikës”, Barka vlerësoi qëndrimin e matur të minoritetit grek ndaj këtij problemi, që gjeti menyrën e duhur për të reaguar. Ai tha se shpreson tek një përmirësim të marrëdhënieve mes dy vendeve dhe vlerësoi me këtë rast gadishmerinë e palës greke për fillimin e dialogut. Unë habitem me heshtjen e palës shqiptare, tha Barka. Duke e konsideruar gjyqin e të pesteve një element thelbësor të krizës, Barka shpreson se me mënjanimin e tij,

në mikrofonin e “Zërit të Amerikës” Barka e shpjegon krizën si më komplekse. Ai e lidh atë me gjendjen e vështirë në Ballkan dhe krizës ballkanike në përgjithësi. Ai nuk përjashton mundësinë e krizave të ardhshme dhe bën thirrje për t’u mbështetur tek përvoja e dy popujve për të shmangur konfrontimet. Duke mos qenë i bindur për kthimin ose jo të pesë të arrestuarve në jetën politike të Omonias, Barka kërkoi prej tyre tolerancën e nevojshme për t’i parë problemet pa kompleksitet e vuajtjeve që kaluan. Omonia nga ana e saj, tha Barka, e mori një mesazh dhe unë uroj që në të ardhmen politika e saj të mbështetet më shumë tek minoriteti grek dhe jo tek qëndrimet nacionaliste, që gjenden në Shqipëri në Greqi por dhe më tej, nga frymëzohen shpesh nga të dyja palët.

shpreson se me mënjanimin e tij....

Për mikrofonin e “Zërit të Amerikës” Barka e shpjegon krizën si më komplekse. Ai e lidh atë me gjendjen e vështirë në Ballkan dhe krizën ballkanike në përgjithësi.

Ai nuk përjashton mundësinë e krizave të ardhshme dhe bën thirrje për t’u mbështetur te përvoja e dy popujve për të shmangur konfrontimet.

Duke mos qenë i bindur për kthimin ose jo të pesë të arrestuarve në jetën politike të OMONOIAS, Barka kërkoi prej tyre tolerancën e nevojshme për t’i parë problemet pa kompleksitet e vuajtjeve që kaluan.

OMONIA nga ana e saj, tha Barka, e mori një mesazh dhe unë uroj që në të ardhmen të mbështetet më shumë tek minoriteti grek dhe jo te qëndrimet nacionaliste që gjenden në Shqipëri, në Greqi por dhe me tej, nga frymëzohen shpesh lëvizje të caktuara politike.

Nga Panajot Barka

Hapja e një kapitulli të ri kërkon predispozicion real.

18.02.1995

Shqipëri - Greqi

Hapja e një kapitulli të ri kërkon predispozicion real

Vendimi i kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, Z. Brozi, për lirim me kusht të 4 minoritarëve, duhet konsideruar si një moment tjetër i rëndësishëm në favor të institucionalizimit të koncepteve e mendësive të një shoqërie të emancipuar e demokratike, dhe të përpjekjeve të gjithanshme për të shembur ato grehina totalitariste që filluan të rindërtohen sërisht në të gjitha strukturat shtetërore dhe në mënyrën e funksionimit të tyre. Si i tillë akti i Brozit i shtohet sfidës së gazetarëve ndaj përpjekjeve të

pushtetit për të penguar fjalën e lirë, i shtohet pjekurisë popullore më 6 nëntor, që nuk lejoi të riinstalohej kulturi i njëshave, i shtohet aktit të deputetëve në janarin e shkuar, të cilët treguan se nuk mund të vazhdojnë të jenë shprehës të urdhërave të këtyre njëshave dhe me votën e tyre i dhanë një mbështetje drejtësisë shqiptare në rrugën e fitimit të pavarësisë nga urdhërat, politika dhe diktati.

Në kushtet e egzistencës së komplekseve të vjetra të shtetit të "parast" (në shtetin e ri të ngritur nga pushteti i PD-së) vendimi i Brozit ishte më i miri që mund të mirrej, ndërsa si akt juridik, përbën një fitore tjetër drejt pavarësisë së drejtësisë sonë. Njëkohësisht ai thelloi më tej krizën në disa hallka të shtetit, të cilat konstitucionin demokratik e kishin zëvendësuar me bindjen absolute ndaj kreut të shtetit, bindje që në rastin konkret kishin të bënin pse jo edhe me skenare për një orientim të gabuar, madje të rrezikshëm të politikës së jashtme me fqinjët.

Drejt këtij konkluzioni të çon reagimi i Gazidedes ndaj vendimit të Brozit dhe pohimi i tij, sipas Brozit, që në këtë

vendim kreut të SHIK-ut i vajti dëm puna e 6 muajve! Shtohet këtu publikimi i aktakuzës së prokurorisë ushtarake dhe gjyqi ndaj 5 ushtarakëve përgjegjës për masakrën e Peshkëpisë, (e cila shërben si një pikë kulmore në dimrin e marrëdhënieve Shqiptaro-Greke), ku fajtori kryesor, ish shefi i komisariatit të Gjirokastërës (në bazë të akt-akuzës shkeli tre dispozita kryesore ligjore, lidhur me vendosjen, mënyrën e stërvitjes dhe qëndrimit të rutëve tanë në repartin e Peshkëpisë) jo vetëm s'u dënua, jo vetëm nuk humbi vendin e punës

si të akuzuarit e tjerë, por vazhdon i qetë punën në organet e SHIK-ut.

Deduksionet, lidhur me skenarë të përcaktuar për keqësimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me Greqinë, i përforcon akoma më shumë edhe heshtja e Tiranës zyrtare, pas gatishmërisë së Athinës për shkrirjen e akujve në marrëdhëniet ndërshtetërore. (Kujtojmë se kur Athina zyrtare vinte kushte për dialog me Tiranën, të drejtat e minoritetit, Tirana, s'linte rast pa theksuar se i përmbahej parimit të dialogut si mënyra më e mirë për të zgjidhur problemet. Në këto rrethana vendimi i Brozit i ngjante guximit të njeriut të fabumës, i cili guxoi t'i afrohej ariut dhe ta shpëtojë atë nga dhimbjet vdekjeprurëse duke i hequr nga këmba gjembin që i kishte shkaktuar një infeksion të qelbëzuar.

Duke mos dashur të jem edhe në vijim metaforik, dua të theksoj se plagët që u hapën do të vazhdojnë të egzistojnë po nuk i shëruan qeveritë e të dy vendeve.

Po kështu, duke e konsideruar të mbyllur periudhën e fundit 9 mujore të akujve të frikshëm në marrëdhëniet Greko-Shqiptare, do të deshëm të theksonim se hapja e një kapitulli të ri kërkon mbi të gjitha, predispozicion real e pa

paragjykimet e së kaluarës nga të dyja palët, ku secila të shikojë ç'humbi nga ky konfrontim politik-diplomatik.

Përsa i përket palës shqiptare, themi se fitoi një përvojë e mori mësimë lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi e të pjesëtarëve të minoritetit në veçanti, për respektimin e drejtësisë si institucion bazë i demokracisë, e të institucioneve ndërkombëtare. Lidhen këto mësimë edhe me rrugën që duhet ndjekur për të shkuar në Evropë dhe njëkohësisht me shkurozimin e politikës tonë të jashtme nga grotesku provincial.

Përsa i përket palës greke do të ishte gabim i madh të mendohet e të thuhet se ajo fitoi një betejë politike e diplomatike me Shqipërinë. Një gjykim i tillë është e sigurt se nuk do të çojë në vendosjen e raporteve të drejta mirëkuptimi e bashkëpunimi reciprok në të ardhmen, por do të çojë në marrëdhënie të paragjykuara. Fitorja e palës greke pas dimrit, të konsideruar të shkuar, ndërshtetëror, qëndron në atë se arriti t'u heqë nga dora e qarqeve e silogjeve të caktuara flamurin nacionalist në trajtimin e çështjes së minoritetit grek në Shqipëri dhe trajtimin e kësaj çështjeje me përgjegjësi nga vetë qeveria greke.

Edhe vetë minoriteti grek në Shqipëri fitoi një përvojë të re, kuptohet pas një sprove të vështirë. Ky minoritet tregoi që di të orientohet drejt zgjidhjeve që i sjellin ekuilibër edhe kësaj here nuk u shpërbë, nuk ra viktimitë e asnjë lloj manipulimi, shmangu me stoicizëm çdo ëndër joshës nacionaliste apo situatë reale konfrontuese dhe zgjodhi si të vetmen rrugë mbijetese, bashkëegzistencën paqësore me popullin shqiptar. Ai tregoi se di të ndërtojë marrëdhënie pa paragjykimet nacionale e fetare.

E
A
N
C
A

18 shkurt 1995

A
T
T
E
R
A
N

Pikërisht tek ky originalitet ballkanik, në kushtet e dështimit të politikës perëndimore në rajonet e tjera të Ballkanit; ku nuk u respektua si zgjidhje politike bashkëjetesa, por shpërbërja e shteteve dhe mbyllja e shoqërive etnike nga njera-tjetra; sigurisht që përbën edhe në të ardhmen një rrezik eventual për fatin e kësaj bashkëjetese paqësore!!

Përsa i përket tani çështjes së të pestëve, duhet thënë se ata tani janë të lirë dhe për këtë liri ata duhet t'u jenë mirënjohës të gjithëve, dhe në radhë të parë minoritetit grek, i cili pranoi të vuajë edhe ai, si komunitet, për lirimin e tyre. Tani ata e dinë se ç'do të bëjnë me lirinë e tyre, veçse një gjë duhet të kenë parasysh, që, në asnjë mënyrë, për të shprehur interesat e ndonjë të treti ndaj të cilit mund të kenë detyrimë më shumë, s'duhet të bëhen litar nëpër këmbë minoritetit.

Panajot Barka

Shqipëri - Greqi

MARRREDHENIET NE UDHEKRYQIN E BISEDIMEVE



Pas Presidentit Gjerman në Tiranë vjen ministri i Jashtëm i Greqisë K. Papulias. Kjo vizitë po të shikohet në kontekstin e platformës që shtroi Herkog, nuk mund të vlerësohet vetëm në funksion të përmirësimit të marrëdhënieve midis dy vendeve, por edhe të vëzhgimit të Tiranës drejt Europës. Opozita Shqiptare edhe në këtë drejtim tregoi gatishmëri këmbëngulëse, madje edhe në periudhën më të nxehtë të acarimeve greko-shqiptare, duke e paguar këtë shpesh me kosto politike, (pasi akuzohej nga pozita për tradhëti kombëtare). Gatishmëri, bile befasuese për Athinën, tregoi gjatë vizitës së Presidentit Gjerman në Tiranë, edhe krali i shtetit shqiptar, S. Berisha, edhe ministri i Jashtëm Sereqi. Në Athinë udhëtimin e Papuliasit e vlerësojnë, siç thotë ministri grek i Financave, si më të suksesshmin e qeverisë së PASOK-ut. Ai do të japë mundësi për konkretizimin e një sërë marrëveshjesh programesh për fusha të ndryshme. Legalizimi i emigrantëve të paligjshëm shqiptarë në Greqi, hapja e tri rrugëkalimeve të reja komunikimi ndërshtetëror, hapja e një banke greke, (që do të mund të nxisi investimet greke në Shqipëri e që do të mund të thithi të ardhurat e shqiptarëve në Greqi, e si pasojë nxitjen e iniciativës së tyre inestuese në Shqipëri); ndërtimi i akseve rrugore, zbatimi i programeve të ndryshme në zonat përkatëse ndërkufitare, duket se përbëjnë disa nga sektorët e bashkëpunimit greko-shqiptar, por që varen nga niveli politik i marrëdhënieve. Qeveria greke ka kohë që përgatitet për aspektin konkret të këtyre propozimeve.

Megjithatë Athina, duket se tundohet nga mosbesimi i përsëritur i Tiranës

ndaj saj. Ajo akoma nuk është e sigurtar plotësisht se në favor të kujt shkon kjo përpjekje e saj, - të marrëdhënieve që realisht duan popujt, apo të rritjes së kredibilitetit të qeverisë Meksi. Në këtë kuadër gazeta "Kathimerini", nga më seriozet e shtypit grek shkruan se Papulias duhet të shkojë pa iluzione në Tiranë. Kjo sepse, sipas gazetës, reagimi i Berishës akoma nuk është i çliruar nga orientimi antigrek, por thjesht është detyruar të rigëlltitet nga hapat greke drejt rivendosjes së dialogut dhe nga zhvillimet e brendshme politike. Vëzhgues të tjerë paralajmërojnë se përpjekjeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore u rrinë mbi krye si shpata e Demokleut, ose incidentet provokative, ose kërkesat e Tiranës që konsiderohen të paqena prej Athinës.

Nga një këndvështrim i tillë dhe nga analiza e fakteve të tjera, nuk dihet me saktësi se cilave sinjale iu përgjigj Berisha lidhur me gatishmërinë e shprehur për vizitën e Papuliasit në Tiranë. Ju përgjigj atyre që vijnë nga përtej oqeanit apo atyre të zyrtarit të lartë gjerman dhe njëkohësisht përfaqësues i Europës së Bashkuar? Përgjigja e kësaj pyetje, mendoj se ka rëndësi prioritarë për cilësinë dhe nivelin e marrëdhënieve Shqiptaro-Greke.

Lajme që mbërrijnë nga Athina bëjnë të ditur se amerikanët tregohen shumë të zellshëm për përgatitjen e udhëtimit të Papuliasit drejt Tiranës. Para pak ditësh ishte përsëri gazetë "Kathimerini", që nënvizonte se, vizitën e ministrit të Jashtëm Grek e përgatitjen greko-amerikan, i cili u pa para burgut të Tiranës, bashkë me personelin gjatë procesit gjyqësor të katër minoritarëve. Pak ditë më vonë media greke publikoi

letërën e Kristoferit drejtuar Papuliasit, letër, që përpos konsideratave pozitive për qëndrimin e qeverisë greke në lidhje me Shqipërinë, përmbante, në formën e propozimit, edhe axhendën e bisedimeve në Tiranë. (!!) (Axhenta amerikane përfshin çështjen e kufirit, legalizimin e emigrantëve të paligjshëm shqiptarë në Greqi, nxitjen e investimeve greke në Shqipëri dhe dy çështje që lidhen me bashkëpunimin ushtarak dypalësh).

Në axhentën e propozuar nga amerikanët, vihet re se mungon çështja mbi shqyrtimin e problemit të minoritetit grek në Shqipëri. E çuditshme është se, edhe Berisha, gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me z. Hercog, e konsideroi të ezauruar këtë problem. Duket se edhe vetë Papuliasit ka zëvendësuar emrat të formula e njohur përkatëse e marrëdhënieve greko-shqiptare, që për Greqinë, "Rruga për në Tiranë kalon nga minoriteti grek në Shqipëri". Mirëpo për një qëndrim të tillë, ashtu si dhe për disa probleme të tjera të udhëtimit të Papuliasit, duket se nuk pajtohen, sipas shtypit grek, deri tani të paktën tre homologë të Papuliasit, të cilët mund t'i shkruajnë edhe kryeministrit Papandreu.

Por edhe minoriteti duket se nuk pajtohet me një qëndrim të tillë. Është kjo arsyeja që një grup përfaqësuesish të minoritetit Grek në pushtetin lokal, intelektualë si dhe figura të tjera të njohura të komunitetit grek në Shqipëri i kërkuar, nëpërmjet një letre Papuliasit, që gjatë udhëtimit për në Tiranë të vizitojë dhe minoritetin. "Është e vërtetë se minoriteti, - komentojnë nënshkruerit e letrës drejtuar Papuliasit, - ka probleme të rëndësishme e të pazgjidhura, prandaj dhe vizita e Papuliasit në Tiranë nuk mund të konceptohet pa marrjen e garancive të plota për zgjidhjen e tyre e që, kuptohet, lidhen me respektimin e të drejtave njerëzore e kombëtare. Në këtë kuadër neglizhenca e tyre, po të kemi parasysh edhe gjykimin e Herzogut për këto probleme, do të thotë që marrëdhëniet ndërshtetërore të mbeten sërisht të mbarsura me konfliktet potencialë, dhe përmirësimi i marrëdhënieve të jetë i përkohshëm e aspak në favor të popujve, por në dobi të interesave të të tretëve, që duan një gjendje të acaruar në rajon. Kjo pra do të thotë që rëndësia gjeostrategjike e Shqipërisë, bashkë me zhvillimet e brendshme politike mund t'i rrezikojë sërisht marrëdhëniet Greko-Shqiptare.

Panajot Barka

Analiza

Exoj carhu... a... lo B B C

Analiza

Domosdoshmëri e zgjedhjeve dhe dilema Berishiane

hbc
Zgjedhjet e parakohshme përbëjnë një imperativ për vendin me qëllim që t'i jepet fund gjendjes paradoksale politike në vend; proceseve deformuese mbi demokracinë e atrofizuar mbi institucionet e shtetit juridik: me qëllim që të shmanget rrethi vicioz i hakmarrjes politike, të ndalet korrupsioni vertikal në piramidën e shtetit, të krijohet klima e mirë që tërheq investitorët e tjerë.

Kuptohet që Berisha nuk mund të qëndrojë më indiferent ndaj këtyre fenomeneve, por reagimi i tij me shumë diktohet nga ndikimi i drejtpërdrejtë mbi pozitën e PD-së e cila, funksionon tani politikisht nën komandën e tij dhe më së shumti, në shërbim të tij. Gjithkush e kupton që PD-ja, jo vetëm është përgjegjëse për gjendjen e krijuar por edhe për vete i ngjan një fruti të pjekur deri në kalbëzim dhe sado përpjekje që të bëjë Berisha nuk mund të mbahet më i varur në degën e pushtetit.

Zgjedhjet e parakohshme përbëjnë një mundësi për të shpëtuar PD-në nga shpërbërjet e mëtejshme dhe nga rreziku i përjashtimit të saj nga rotacioni politik, opozitë-pozitë në lidhje me pushtetin.

Mirëpo, nga ana tjetër duhet të vihet në dukje se infeksioni i korrupsionit në Parti, pushtet e makinë shtetërore nuk e lenë Berishën të hedhë një hap drejt zgjedhjeve të parakohshme. Po ashtu Ai ka ende punë me armiq të brendshëm në Parti. Të gjithë të ikurit duket se kanë lënë brenda partisë pasuesit e tyre, të cilët me një qejfmbetje të re mund t'i hapin sërish andralla. Më i

vështirë duket se është Selami, pasuesit e të cilit arritën të maskohen në momentin e fundit. Kështu Berishës i duhet akoma kohë edhe për të përzgjedhur emrat e listës së deputetëve, nga ku sigurisht do të mungojë emri i tij, por edhe garanci për ta.

Në këtë kuadër dilema e Berishës dhe e stafit të tij tepër të ngushtuar, është ndoshta më dramatike se ajo Hamletiane.

Opozita pasive

Veprimi i opozitës përsa i përket marrjes së vendimit për zgjedhje të parakohshme vazhdon të mbetet pasiv. Arsyeet nuk duhen kërkuar vetëm në atë se opozita nuk përbën shumicën e duhur në parlament, por edhe në arsye të tjera. Kështu, në Shqipëri individit nuk vepron si faktor koshient për misionin e tij demokratik në shoqëri. Ai i shmanget përballjes me shtetin, qoftë edhe me njëte demokratike dhe përpjekjet të përfytyrë nga dobësitë e shtetit, apo nga nevojat e tij për shërbime të individit ndaj tij, pavarësisht nga çmimi i paguar përsa i përket personalitetit.

Nga ana tjetër opozita si forcë politike nuk ka ndihmesën e atyre mekanizmave të cilat do t'i quanim institucione dytësore demokratike, ku më i spikatur duhet të ishte roli i sindikatave. Këto mekanizma ose nuk ekzistojnë realisht, ose edhe kur ekzistojnë më shumë janë rripa transmisioni të partisë shtet, se sa janë leva demokratike. Një fenomen i tillë ndodh për faktin se në Shqipëri, në mënyrë paradoksale, politika zhvillohet krejt e pavarur nga veprimi ekonomik, ku i dyti zhvillon aktivitetin e vet

jasht Shqipërisë. Ekonomia shqiptare i ngjan një rrethi të hapur ku fillimi dhe mabrimi i tij gjenden jashtë vendit. (Fillimin e përbën potenciali njerëzor shqiptar në vende të ndryshme, si e vetmja forcë që prodhon para për Shqipërinë, dhe fundin e këtij rrethi e përbën përfundimi sërish i këtyre parave, nëpërmjet tregtarëve shqiptarë, tek prodhuesit perëndimorë. Pjesën e rrethit që kalon në Shqipëri e përbëjnë konsumatorët shqiptarë të cilët sigurojnë parat për të jetuar nga puna e njerëzve të tyre jashtë Shqipërisë).

Pra faktori primar, ai ekonomik, me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet politike në Shqipëri nuk vepron, ndaj dhe zhvillimet politike në vend nuk kanë një ligjësi objektive, gjë që i jep mundësi njëshit të shtetit të punojë për interesa të ngushta të një grupimi të caktuar, apo dhe të vet personit

Berisha do të kërkojë në zgjedhjet e ardhshme vetëm fitore...

Çdo forcë politike futet në zgjedhje për të fituar por për të pranuar edhe humbjen, por Berisha, fatkeqësisht hyn në zgjedhje vetëm për të fituar dhe kjo gjë e bën atë në një masë të madhe edhe të rrezikshëm.

Cili mund të jetë arsenalit i betejës elektorale të tij?

Berisha duket se bën një përpjekje të sforcuar për të rikrijuar në mënyrë mekanike formulën politike të 1991-1992 që solli PD-në si emergjencë në push-

et. Mirëpo, fronti i atëhershëm antikomunist kishte në thelb të aksionit politik, përplasjen për përmbyshjen e rregjimit të instaluar komunist. Kjo ishte historikisht e demostoshme, logjikisht e pranueshme dhe taktikisht e zbatueshme. Ajo që shikohet tani është se edhe pas 3-4 vjetësh Berisha mbeti tek e njëjta skemë taktike, ideologjike e strategjike. Ai nuk merr parasysh se periudha që ndërmjetësoi, solli shtrësimin në parti të ndryshme politike të frontit të atëhershëm të djathtë, të Partisë Demokratike, dhe, komunizmi jo vetëm nuk ka pushtetin por edhe kthimi potencial i tij në pushtet është i pamundur. Kriza e zgjedhjeve të situatës inferiore në të cilën ndodhet aktualisht PD e detyrojnë atë t'u rikthehet edhe një herë atyre forcave politike që në fakt u detyruan nga PD-ja dhe Berisha, për shkak të mosrespektimit të interesave të tyre në çështje politike, ekonomike dhe kombëtare nga ana e PD-së. Pra edhe me këtë aleancë parazgjedhore PD-ja vetëm sa do të shtojë paksa numrin e biletave për në parlament. Dihet gjithashtu se PD-ja dhe Berisha kanë në dorë akoma mjetet e informacionit, qeverinë, rendin SHIK-un.

Faktorët e jashtëm

Ndër këta faktorë mund të veçohen: faktori amerikan (përsa i përket rëndësisë që i kushton zhvillimeve politike në Shqipëri); dhe faktori grek (përsa i përket ndryshimit të qëndrimit të mbajtur kohët e fundit nga Tirana ndaj Athinës).

Fakt është që SHBA bën investime të konsiderueshme politike tek personi i zotit Berisha

dhe te partia e tij. Por amerikanët që shpresonin kaq shumë te roli politik i Berishës u zhgënjyen shumë kur zbuluan më 6 nëntor pjekurinë e popullit shqiptar. Tani ata mund të aplikojnë edhe këtu strategjinë e tyre të mbështetjes së krahut më të fortë, që sigurisht kësaj here nuk është ai i Berishës. Problemi është se amerikanët nuk investuan vetëm për Berishën por edhe për Zhulalin, gjë që do të thotë se investimet e dyta janë politikisht më afatgjata.

Po faktori i dytë?

Berisha është i ndërgjegjshëm se Greqia jo vetëm që mban 300 mijë shqiptarë në punë e me shtëpi, por di gjithashtu se shumë familje të tjera në Shqipëri kanë pikërisht shpresë të ardhurash mundin e djersën e tyre. Ai di gjithashtu se kjo do të thotë që çdo përplasje me Greqinë ka një refleksim të brendshëm politik rëndësia e të cilit, varet edhe nga faktorët të tjerë të brendshëm. Rregullimi i marrëdhënieve me Greqinë, kuptohet nuk presupozon direkt kthim votash në favor të Berishës apo kujtdo tjetër. Një gjë e tillë mund të çojë në fund të fundit në krijimin e një klime mirëkuptimi. Po kështu frytet e një bashkëpunimi nuk arrihen me të njejtën shpejtësi sa ndodh dhe prishja.

Si përfundim do të thonim se Berisha është i rrethuar në një vath ku dalja e vetme është shtrungja që në politike i thonë "zgjedhje të parakohshme". Kjo do të thotë që PD-ja duhet të përgatitet edhe për humbjen dhe pasojat që rrjedhin prej saj, veçanërisht për të.

Panajot BARKA

Në një vjetorin e masakrës

A është thënë gjithshka për Peshkëpinë?!

10 prilli 1994, dita që në marrëdhëniet shqiptaro-greke, është lidhur me incidentin e përgjakshëm kufitar të Peshkëpisë edhe në kushtet e para një viti, edhe në kushtet e përpjekjeve për dialog, fqinjësi të mirë e bashkëpunim, nuk mund të kujtohet vetëm si një ëndërr e keqe. Kuptohet që të dyja palët duhen përsëritur për faktin se në emër të miqësisë dhe lidhjes natyrale midis popujve dhe stabilitetit në rajon, e lënë menjandë këtë ngjarje që ftohu në maksimum kryeqytetet e të dy vendeve. Por qoftë për faktin se e vërteta nuk doli sheshit dhe mund të përbëjë nesër sërish një pretext për një dimër të ri, ose edhe mund të përsëritet, apo edhe për faktin se ngjarja, tani vit pas viti, të kujton fjalën e urtë se u mbar mali dhe polli një mi, për të dyja rastet pra, duhet këmbëngulur për të nxjerrë disa konkluzione, për të kërkuar përgjegjësitë, me të vetmin qëllim mos përsëritjen e ngjarjeve të tilla.

Kohët e fundit u vu re një nxitim për të konkluduar për përgjegjësinë e masakrës, nga që u gjenden armët e rrëmbyera nga reparti ushtarak i Peshkëpisë dhe meqë 7 veta në Greqi janë nën hetim lidhur me këtë çështje.

Mirëpo një eksponent grek jo zyrtar i deklaroi në koefidencë një gazetari grek se: "çdo gjë mund të hamendësoni, ose është krejt e pathemeltë, ose është fare pak afër të vërtetës" (?), gjë që në një farë mënyre të thotë se është tepër e vështirë akom për t'u dhënë përgjigje pyetjeve se, kush e bëri dhe pse e bëri sulmin e armatosur mbi raportin ushtarak të rekrutëve në Peshkëpi të Gjirokastrës.

Një vështrim retrospektiv, me gjakftohtësinë që të jep largësia në kohë, të ndihmon për të parë e për të kuptuar se shumë probleme janë tepër të ndërlikuara. P.sh. 5 njerëzit e sulmit të armatosur dinin me hollësi të admirueshme gjithshka në lidhje me raportin (?) Dinin se armët e rojeve ishin pa municion (?) Disa prej tyre flisnin edhe greqisht edhe shqip (?) Ishin tepër gjakftohtë, (d.m.th. profesionist) dhe të ngeshëm (d.m.th. njihnin se rekrutët nuk kishin asnjë mundësi për të kërkuar ndihmë) (?) Mandej, nuk bënë asnjë përpjekje për të fshehur gjurmët që të çnin në tokën greke (...).

Nga ana tjetër, rekrutët, (sipas aktakuzës në gjyqin ndaj oficerëve tanë), u transferuan në raportin e Peshkëpisë në kundërshtim me ligjin ushtarak në fuqi. Nga konkluzionet e hetimeve të para, bëhet fjalë për sulm me objekt armët, tregu i të cilëve është tepër i zhvilluar brenda vendit. Pak orë më vonë "U rezultua" se ishin "komandos të specializuar të ushtrisë greke (?) Pala jonë nuk zbaton asnjë normë të njohur në rast inci-

dentësh ndërkufitare, por akuzon menjëherë shtetin dhe qeverinë greke, madje kërkon ndërhyrjen e organizmave ndërkombëtare deri në Këshillin e Sigurimit (?) Në Gjirokastrë, një ditë më pas Ministri i Mbrojtjes vringëllin armët me një gjuhë që do ta kishte zili çdo ihtar i periudhës së luftës së ftohtë (?).

Heshja e Greqisë, që në fakt u përmbahej normave dhe përvojës diplomatike, i dha zemër Tiranës për t'i fryrë më shumë zjarrit të ndezur. Po ashtu duhet të mos harrojmë se incidenti ndodhi pikërisht ditën e konferencës së dytë të OMONIAS, që pas tetë ditësh në shtëpitë e mëse 50 krerëve të saj ndodhin bastisje të tipit blitë. Pesë veta përfundojnë në burg me akuzat të karakterit politik nga më të rëndat.

Tirana edhe pas kësaj vazhdon të jetë në sulm. Mirëpo në vijim incidenti i Peshkëpisë, që duhet të çonte të paktën dy ministrit tanë në dorëheqje, konvertohet në çështjen të të pestëve të OMONIA-s dhe problemi merr për çudi një shtrirje me përmasa shumë dimensionale, jo vetëm për marrëdhëniet ndërshtetërore, por edhe për rajonin në përgjithësi.

Përgjigje për këtë ende nuk është dhënë. Përpjekjen e parë e bënë në këtë drejtim Eduard Selami, pak ditë para se të shkarohej nga posti i kryetarit të PD-së. (përgjigje që e konfirmoi më vonë edhe ministri Serreqi). Ne, tha Selami në politikën me Greqinë ramë shpesh viktimat të qarqeve të ndryshme. Megjithatë duket se kjo nuk është e tëra.

Tirana shfrytëzoi momentin për të tërhequr vëmendjen nga problemet e brendshme duke e spostuar në çështjen kombëtare. Një gjë e tillë i erdhi për mbarë partisë në pushtet për të mënjeluar luftën e opozitës, madje për ta sulmuar atë dhe kundërshtarët e vet politikë, duke i akuzuar si tradhëtarë e filogrek. E gjithë kjo serviret me parrullën e luftës për të shpëtuar jugun e Shqipërisë nga Helenizimi. Në qendër të vëmendjes vihet minoriteti grek në Shqipëri i konsideruar nga njëra anë si bërthamë rrezatuese e planëve helenizuese të Greqisë dhe nga ana tjetër si një objekt konkret, operacionet mbi të cilin mund të shërbenin si mjet për të mbajtur për një kohë të gjatë në ndezur konfliktin, por edhe për të ushtruar presion e frikë mbi të. Një taktikë e tillë i jepte mundësi edhe për të mbjellë vija ndarëse midis shqiptarëve dhe minoritetit duke e penalizuar këtë të fundit për antishqiptarizëm.

Në këto momente diplomacia greke shumë e nervozuar sa e lodhur nga betejja jo të pakta diplomatike me fqinjët, por edhe nga presionet e brendshme të partive politike opozitare dhe të qarqeve të

ndryshme, i përgjigjet Tiranës me të njetën monedhë. Ajo shfrytëzon me këtë reagim bashkë me pozitën superiore në Europë edhe akuzat e Tiranës, të cilat ndërsa bëheshin për konsum të brendshëm nuk kishin argumentimin e duhur për t'u servitur në Europë. Për pasojë ato kishin në shumicën e rasteve pasojat negative për Tiranën. Mjetet e përdorura nga Athina - bllokimi i ndihmave komunitare, kthimi i refugjatëve, bllokimi i kufirit e tjerë, përkeqësuan edhe më zhvillimin e Shqipërisë. Thëksojmë gjithashtu se gjatë gjithë kësaj periudhe vëmendja e Tiranës ishte plotësisht e spostuar nga problemi i Kosovës (pse vallë?) dhe në arenën ndërkombëtare i mësohet me forcë problemit të minoritetit grek në Shqipëri. (Cili është interesi i Tiranës për këtë çështje? Është vërtetë viktimë apo e bëri që të sigurojë spostimin e vëmendjes nga problemet e brendshme politike si dhe nga Kosova?)

Megjithatë është për t'u vënë re se si akulli i marrëdhënieve në nivel shtetëror u sfidua nga raporti i marrëdhënieve që ruajtën dhe zhvilluan midis tyre minoritarët grekë dhe popullsia shqiptare, ose popujt midis tyre. Kjo është një dëshmi e re e ekzistencës e një subshtrati të përbashkët bashkëjetese shqiptaro-greke i pandikuar nga kufijtë, e që mesa duket ka për t'u hapur punë vazhdimisht njerëzve, klaneve e qarqeve që e mendojnë fqinjin me kufij të pakapërcyeshëm. Po ashtu u vërtetua edhe njëherë se politikat e njohura mbi minoritetet në Ballkan nuk kanë vlerë për këtë pjesë të gadishullit. Kjo kuptohet, nuk përjashton mundësinë e përsëritjes së ngjarjeve të tilla të rënda me pasojat të dëmshme për fqinjësi të mirë. (Qarqet përgjegjës e kanë zanafillën tek segmentete e politikës konfliktuale dhe janë pjesë përbërëse e konjukturave të reja politike në rajon.

Kjo do të thotë se vullneti politik i shprehur në Tiranë nga të dy palët, për të mënjeluar ngjarje të tilla, mund të mos jetë i mjaftueshëm për të penguar ndikimin e tyre në këto marrëdhënie kur ndodhin.

Pra ato mund të mos inspirohen nga qarqe me potencë të kufizuar brenda një shteti të caktuar, por nga qendra që shpesh instrumentalizojnë një politikë me globale në një rajon të caktuar. Ndaj dhe ngjarja e Peshkëpisë nuk duhet parë si një diçka e thjeshtë ajo nuk duhet nënvleftësuar dhe politikanët apo qeveritë e dy vendeve në rastin konkret, të ndikohen nga vullneti i popujve dhe jo nga interesat e ngushta politike që në një moment të caktuar mund të bien në kundërshtim me ato të popullit që përfaqësojnë.

Panajot Barka

Nga Panajot Barka
A është thënë gjithcka për Peshkëpinë?!
13.04.1995

